



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:061050

Datë: 11.10.2019

Numri i dokumentit: 00571225

**P.nr.197/2019**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË S.**, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. B. nga fsh. M. K. S., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, NR. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.893-3/16, të datës 12.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të Pokurorit të Shtetit Shpend Binaj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat, Refki Gega nga Suhareka, me datë 08.10.2019 mori, publikisht shpalli dhe me date 11.10.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari**, F. B. , nga babai I. dhe nëna V. B. e lindur A., i lindur me ....., në fshatin M. K. S., ku edhe tani jeton, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më pare.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse prej datës së pavërtetuar e gjer me dt.09.12.2015, në lokalin e tij në fshatin M., K. e S.s, si shfrytëzues përfiton nga shërbimi, që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike me njuhësorë i cili është pa pllomba shtetërore, në brendi numëruesi i njuhësorit është manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

-këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, NR. 06/L-074,

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 të KPK-së, dhe nenit 359 par. 1 dh2 dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

**DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej **200 (dyqind) euro**, të cilin është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet me 10 (dhjetë) ditë burg duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara KEDS Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.893-3/16 të datës 12.05.2016, kundër të akuzuarit F. B. , nga fshati M. K. S., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve K.le nga neni 320 të KP-së.

Në ri gjykim, Gjykata duke vepruar sipas sugjerimve të Gjykatës së Apelit, Prokurori i shtetit Shpend Binaj, konform nenit 3 të KP-së, bëri ri cilsimin e veprës penale nga vjedhja e shërbimeve Komunale nga neni 320 të KP-së, Kodi Nr. 04/L-082, në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, NR. 06/L-074, I cili në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.II.nr.893-3/16 të datës 12.05.2016, kundër të akuzuarit F. B. , nga fshati M. K. S., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPK-së, NR. 06/L-074 dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke theksuar se gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë u vërtetua në tërësi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, me ç rast palët u pajtuan që dëshmitarët mos të ftohen dhe të dëgjohen përsëri, por deklaratat e tyre të lexohen.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën përfundimtare deklaroi: e kundërshtoj në tersi aktakuzën e PTH PP/2 II 89333/16 të dt 12.05.2016 sepse e njëjta në asnjë prove asnjë fakte nuk është e bazuar. I akuzuari F. B. e ka shfrytëzuar lokalit afarist në fsh. M. qe nga viti 2012 dhe ka paguar rrymën elektrike të shpenzuar, lokali është shfrytëzuar edhe nga qira dhënës të tjerë dhe njehsori ka qen i vendosur qe nga viti 1972 i akuzari si laik në fushën energjisë elektrike, nuk ka vërejtur se njehsori ka qene i prekur në momentin e marrjes me qira sepse i njëjti edhe gjate kontrollit detal qe është bere është vërtetuar se nuk vërehen dëmtime nga jashtë njehsori ka pasur dy bllomba po ato kanë qene të pa vulosura, aktakuza e PTH nuk vërteton se i akuzuari ka ndërmarr ndonjë veprim me të cilit do të ndikonte në shkaktimin e veprës penale, gjithashtu nuk precizohet koha e kryerjes së këtij veprimi, dua të theksoje se mungon edhe pasoja e një veprimi të tillë në kemi dëshmi qe i kam propozuar Gjykatës se para vendosjes së njehsorit të ri është e njëjtë, andaj konsiderojmë se nuk janë formuar asnjë element i veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 kështu qe i propozoj gjykatës se aktakuza e PTH ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se prej datës së pavërtetuar e gjer me dt.09.12.2015, i akuzuari në lokalit e tij në fshatin M., K. e S.s, si shfrytëzues ka përfituar nga furnizimi përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehësorë i cili është pa pllomba shtetërore, në brendi numëruesi i njehësorit është manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga shkresat e lëndës dhe atë procesverbalit me nr.1472940 dt.29.12.2015 i hartuar nga KEDS, procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehësorit elektrik nr.33/14 të dt.14.12.2015 i departamentit AMR dhe Kalibrimi i njehësorëve, në faturën DPZ16HP10351 të dt.06.01.2016 si dhe fotodokumentacionit.

Nga procesverbalit me nr.1472940 dt.29.05.2015, u vërtetua se punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë bërë regjistrimin e pajisjeve të cilat janë të kyçura si më afër në përshkrim të procesverbalit. Pas marrjes së njehësorit nga këtu i akuzuari, departamenti AMR dhe Kalibrimi

i njehësorëve në kuadër të KEDS-it në Prishtinë, e ka bërë kalibrimin e njehësorit dhe ka nxjerrë procesverbalin e dt.14.12.2015 nr.33/14 mbi kontrollimin detal të njehësorit të energjisë elektrike me të dhënat teknike me konstatimin se: njehësori elektrik është pa pllomba, i ka dy pllomba të cilat janë të pavulosura, nga ana e jashtme e njehësorit nuk vërehen dëmtime tjera. Ndërkaq në mbrendi të njehësorit komisioni ka vërejtur se: munëruesi i njehësorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numerator.

Nga fatura DPZ16HP10351 të dt.06.01.2016 shihet se shuma e përgjithshme e borgjit të konsumatorit është 1,122.85 euro, ndërsa nga procesverbali i departamentit për konsumator gjegjësisht sektori për rikthimin e humbjeve me nr.30274 dt.06.01.2016.

I akuzuari ka deklaruar se pajtohet tërsisht me deklaratën e mbrojtësit të tij, I njëjti nuk e pranon fajësinë për veprën të cilën akuzohem nuk e kamë kryer.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nga të cilat në mënyrë bindëse u konstatua se i akuzuari ka përfituar nga shërbimi K.I përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në lokalin e tij në M. K. S.s, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehësorë i cili është pa pllomba shtetërore, në brendi numëruesi i njehësorit është manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numerator, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, duke i shkaktuar dëmë material të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prizren.

Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme. Gjykata ka ardhur në përfundim, se faktet që përmban aktakuza janë provuar në tërësi si të bazuara, andaj në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KP-së, paraprkasht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalë juridike, ndërsa deklaratën e të akuzuarit e vlerësoi si qëllim shmangie nga përgjegjësia penale.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjer më tani i pa dënuar, çka nënkupton se nuk ka rënë ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë prej 200 €, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla ose të ngjashme.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË S.**  
**P.nr.197/2019 të dt. 11.10.2019**

Bashk.Profesional  
Feim Bytyqi

**Gjyqtari**  
**Qemal Suka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.